

**PËRCEPTIMI MBI KLIMËN DHE SIGURINË E SHKOLLËS, PERFORMANCA
AKADEMIKE DHE MIRËQENIA SUBJEKTIVE TEK NXËNËSIT E MOSHËS 11-15 VJEÇ**

Ndërveprim Faktorësh

TEMA PËR TITULLIN

**MASTER I ARTEVE NË PROGRAMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM
NGA**

DAFINA ARIFI

EKSPOZE E PUNIMIT TË TEMËS SË MASTERIT



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË

PRISHTINË

SHTATOR 2022

**Përceptimi mbi Klimën dhe Sigurinë e Shkollës, Performanca Akademike dhe Mirëqenia
Subjektive tek Nxënësit e Moshës 11-15 Vjeç
*Ndërveprim Faktorësh***

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Liridonë Jemini - Gashi

Vitet e fundit, ka pasur një konsensus të jashtëzakonshëm midis edukatorëve, politikëbërësve dhe studiuesve në identifikimin e klimës së shkollës si një nga levat kryesore që mund të përdoret për të përmirësuar sistemet kombëtare të shkollave. Hulumentimet e fundit treguan rolin e një klime pozitive të shkollës në promovimin e arsimit, mirëqenies subjektive dhe rezultateve më të mira të nxënësve.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të paraqes një përmbledhje integruese duke u fokusuar në ndërveprimin e katër faktorëve thelbësor të klimës së shkollës si; Siguria në shkollë, mirëqenia subjektive e nxënësve, marrëdhëniet në mjedisin insitucional dhe performanca akademike. Në të njëjtën kohë, hulumtimet e fundit treguan rolin e një klime pozitive të shkollës në promovimin e arsimit, shëndetit dhe rezultateve më të mira të nxënësve (Lenzi et al., 2014; Thapa et al., 2013). Në më të mirën e njohurive tona, asnjë studim ende nuk është bërë mbi këtë subjekt në mënyrë direkte në Kosovë. Prandaj, për të mbushur këtë boshllëk qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtojë literaturë relevante të bazuar në evidencë dhe gjetje empirike mbi përshtypjen e përgjithshme për sigurinë në shkollë dhe përceptimet mbi klimën e shkollës tek nxënësit e moshës 11-15 vjeç, analizuar kështu një ndërveprim faktorësh mbi mirëqenien subjektive dhe performancën akademike.

Teorikisht, ky hulumtim sintetizon parimet nga teoria autoritative e klimës në shkollë, që argumenton që mjediset shkollore janë më pozitive kur shkollat ofrojnë strukturë dhe mbështetje (Bear et al., 2014; Gregory et al., 2012). Realisht, teoria e klimës së shkollës e ka origjinën nga kërkimet mbi stilet e prindërimit (Baumrind, 1966, 1968). Ashtu si një stil prindëror autoritar (Baumrind, 1966, 1968), klima autoritative e shkollës thekson strukturën në formën e rregullave dhe pritshmërive të qarta që zbatohen vazhdimisht, si dhe mbështetjes dhe një mjedisi të ngrohtë dhe të përgjegjshëm (Pellerin, 2005; Gregory dhe Cornell, 2009).

Rrjedhimisht konteksti ku është realizuar ky hulumtim, ka një qasje të kulturës kolektiviste e që kryesisht, në përgjithësi fëmijët përkatësisht nxënësit ndikohen nga të tjerët, dhe janë të orientuar më shumë drejt performancës. Për shkakë të mungesës së gjetjeve empirike direkte mbi mënyrën se si arrihet siguria e lartë në shkollë, përceptimi më i denjë

për klimën shkollore, mirëqenia subjektive dhe rritja e performancës akademike tek nxënësit e moshës 11-15 vjeç në Kosovë, ky hulumtim ekszaminon rëndësinë kryesore të krijimit të një klime sa më të përshtatshme në shkollë tek këta nxënës. Si i tillë ky hulumtim shtrihet mbi disa pyetje hulumtuese të natyrës kryesisht eksploruese si; A ekziston ndërlidhje ndërmjet perceptimit mbi klimën shkollore dhe sigurisë në shkollë? A ndikon klima dhe siguria në shkollë në mirëqenien subjektive dhe performancën akademike tek nxënësit e moshës 11-15 vjeç? A ka ndonjë impakt marrëdhënia mësues-nxënës në perceptimin më të denjë të klimës shkollore?

Klima e shkollës mund të luajë një rol të rëndësishëm për të favorizuar një përvojë pozitive shkollore tek nxënësit. Klima e shkollës përgjithësisht shihet si një konstrukt shumëdimensional që përfshin atmosferën, kulturën, vlerat, burimet dhe rrjetet sociale të një shkolle (Wang dhe Degol, 2016). Koncepti kryesor i elaboruar nga ky hulumtim është edhe përcaktimi i sigurisë në shkollë. Në fakt, siguria në shkollë i lejon nxënësit dhe stafin të presin me padurim të jenë në një mjedis inkurajues, duke promovuar të mësuarit social dhe krijues (Applebury, 2021 dhe Mubita, 2021). Faktorët tjerë ndërveprues të klimës shkollore si; mirëqenia subjektive dhe performanca akademike, sipas gjetjeve janë parë të jenë si një ndër faktorët kyç të promovimit të klimës dhe sigurisë në shkollë.

Sa i përket kornizës strukturore, ky hulumtim është dizajn eksplorues dhe korrelacional, metodë kuantitative, reflektuese dhe i përket një modeli eksperiencial në të cilin të gjithë nxënësit e përfshirë në hulumtim njihen dhe pjesëmarrësit janë kontribues. Ky hulumtim është implemtuar në praktikë në vitin 2022, përgjatë periudhës shkurt-mars gjatë kohës kur arsimi parauniversitar ka qenë duke punuar, në formën fizike por edhe në formën virtuale. Ky hulumtim ka përfshirë gjithsej 200 nxënës të klasës së tetë dhe nëntë (55% djemë dhe 45% vajza), ku mosha e tyre ka qenë 11 deri në 15 vjeç, ($M= 14.23$, $DS= .87$).

Si rezultat i gjetjeve apo analizave të arritura shohim se të gjitha hipotezat janë vërtetuar, që do të thotë se ekziston ndërlidhje pozitive ndërmjet të gjithë faktorëve ndërveprues të perceptimit të klimës shkollore tek nxënësit e moshës 11-15 vjeç. Në anën tjetër, nga koeficienti i Pearson në pajtim me hipotezat e hulumtimit është vërtetuar edhe me anë të analizës korrelacionale, ku tregohet një ndërlidhje pozitive signifikante në mes perceptimit të klimës shkollore dhe sigurisë në shkollë, po ashtu është vërejtur korrelacion pozitiv dhe signifikant gjithashtu në mes perceptimit të klimës shkollore dhe mirëqenies subjektive dhe performancës akademike, si dhe ekziston ndërlidhje signifikante në mes

sigurisë në shkolla dhe performancës akademike tek nxënësit e moshës 11-15 vjeç. Përveç tjerash, gjetjet raportojnë impaktin e perceptimit të klimës shkollore në sigurinë e shkollës tek nxënësit e moshës 11-15 vjeç. Vlera e R^2 , .21 tregon që variabla predikuese shpjegon 21% të variablës së varur. Të gjeturat pra, potencojnë që mënyra se si nxënësit e perceptojnë klimën e shkollës ndikon shumë në sigurinë e shkollës.

Hulumtimi gjithashtu mbështet rëndësinë e elementeve joshkollore të mikrosistemeve (p.sh. faktorët familjarë, komuniteti dhe bashkëmoshatarët). Kështu, një klimë pozitive shkollore reflekton më shumë se çfarë ndodh brenda mureve të shkollës. Një klimë pozitive shkollore duket se përfshin në mënyrë ideale një "fshat" të prindërve, mësuesve, bashkëmoshatarëve dhe modeleve të rritur që punojnë së bashku në komunitet (Shoshani dhe Slone, 2013).

Implikimet e hulumtimit nxjerrin në pah rëndësinë e stafit profesional të shkollës që punojnë së bashku për të përmirësuar klimën shkollore. Psikologët e shkollës mund të angazhohen në parandalim apo preventim, duke punuar me mësuesit dhe nxënësit për të ndryshuar mjediset e shkollës dhe klasës për t'u angazhuar pozitivisht nxënësit (Chory-Assad dhe Paulsel, 2004; Vieno, Lenzi et al., 2013; Vieno, Roccato et al., 2013). Mirëpo, përfundimisht, nevojiten kërkime të vazhdueshme për të hetuar karakteristikat arsimore, strukturore dhe të politikave që nxisin një klimë kohezive sociale në shkollë në mënyrë që të zhvillohen intervenime efektive që nxisin ndjenjën globale të sigurisë së nxënësve në shkollë dhe, rrjedhimisht, ndjenjën e tyre të përgjithshme të mirëqenies.

Në përfundim, studimi aktual parimisht ndihmon në krijimin e programeve intervenuese. Po ashtu, ky studim synon të arrij hartimin dhe zbatimin e programeve intervenuese për nxënësit në shkollat e Kosovës. Mbi të gjitha, duhet elaboruar plani i propozuar i menaxhimit të mësimi dhe duhet të rishikohet, vlerësohet dhe përshtatet për të gjithë nxënësit njësoj, pasi që ky menaxhim mund të ndikoj në përmirësimin e klimës së shkollës. Gjithashtu shkolla duhet të zhvillojë qasjen e menaxhimit të të mësuarit që i përshtatet më së miri kulturës dhe nevojave të të nxënësve dhe siç kërkohet nga kurrikula.